



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut Nënkomisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Tiranë, më _____ 2024

Dokument Parlamentar

RAPORT

Mbi përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit të Lartë të Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, raundi i tretë

Hyrje

Kuvendi i Shqipërisë, me vendimet nr. 63 dhe nr.64, të datës 04.07.2024, vendosi mospranimin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që rezultoi nga hedhja e shortit të dytë të datës 03.07.2024, në Nënkomisionin “Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, meqenëse nuk u arrit shumica prej dy të tretat e votave të të gjithë anëtarëve të tij.

Bazuar në parashikimet e neneve 147 dhe 149 pika 8 të Kushtetutës, si dhe nenit 35, pika 16 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: “Nëse nuk arrihet shumica e kërkuar, nënkomisioni miraton një listë të re, sipas procedurës së parashikuar në pikat 12, 13 dhe 14, të këtij neni, brenda 2 ditëve nga votimi në seancë plenare. Kandidatët e listës së dytë nuk përjashtohen nga procesi i përzgjedhjes në nënkomision në raundin e tretë. Lista e re i paraqitet Kryetarit të Kuvendit dhe hidhet në votim në seancën më të afërt të Kuvendit, por jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e listës. Kuvendi miraton listën e kandidatëve me dy të tretat e të gjithë anëtarëve. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej dy të tretave edhe në votimin e tretë, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur”, mbledhja e rradhës së nënkomisionit për miratimin e listës së re të kandidatëve për raundin e tretë, për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, u njoftua nga Kryetarja në datën 15.07.2024 dhe u zhvillua në datën 16.07.2024.

Në rendin e ditës së kësaj mbledhje ishte votimi për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, raundi i tretë. Bazuar në nenin 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016, lista e kandidatëve për votim për herë të tretë, hartohet dhe miratohet në përputhje me procedurën e parashikuar në pikat 12, 13 dhe 14, të këtij neni si dhe nenit 7, pika 1 të Rregullores së nënkomisionit “Për organizimin dhe funksionimin e nënkomisionit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Në mbledhje, ishin të pranishëm 4 anëtarë të nënkomisionit, pra më shumë se gjysma e anëtarëve. Bazuar në pikën 12 të nenit 35 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të

drejtësisë”, në të cilin përcaktohet se: “...Mbledhjet zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve. Në qoftë se një ose disa anëtarë të nënkomisionit nuk marrin pjesë në mbledhje, nënkomisioni i vazhdon punimet me anëtarët që janë të pranishëm...” nënkomisioni vazhdoi punimet.

Veprimtaria e Nënkomisionit

Kryetarja e nënkomisionit sqaroi se meqenëse kandidaturat e përzgjedhura me short në raundin e dytë nuk morën numrin e nevojshëm të votave sipas përcaktimeve Kushtetuese dhe ligjore, procedura rikthehet në nënkomision për të kryer raundin e tretë.

Procesi i votimit

Sipas kalendarit të punimeve, nënkomisioni në mbledhjen e datës 16.07.2024, vijoi me procesin e votimit të listës së kandidatëve të përjashtuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

Në fillim të procesit Kryetarja e Nënkomisionit shpjegoi për anëtarët, procedurën për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë sipas Rregullores së miratuar nga Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Kryetarja e nënkomisionit hodhi në votim emër për emër kandidatët e pakualifikuar në listën e përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm për të dyja Këshillat sipas përcaktimeve të nenit 35, pika 7, germa “b” të ligjit nr. 115/2016.

Asnjë nga kandidatët nga kjo listë, nuk mori votat e mjaftueshme sipas përcaktimeve të nenit 35, pika 13 të ligjit nr .115/2016, për t’u përfshirë në listën e kandidatëve që i plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji 115/2016.

Më pas, kryetarja e nënkomisionit hodhi në votim për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emër për emër, sipas rendit alfabetik të emrit, listën e përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm me kandidatët që i plotësojnë kushtet, në përputhje me nenin 35, pika 7 shkronja “a”, e ligjit 115/2016.

Në përfundim të procedurës së votimit rezultoi se asnjë nga kandidatët për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk mori minimumin prej 4 votash të nevojshme për t’u konsideruar kandidat i miratuar nga nënkomisioni në përputhje me pikën 14 të nenit 35 të ligjit.

Më pas, Kryetarja e nënkomisionit hodhi në votim për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, emër për emër, sipas rendit alfabetik të emrit, listën e përcjellë nga Sekretari i Përgjithshëm me kandidatët që i plotësojnë kushtet, në përputhje me nenin 35, pika 7, shkronja “a”, e ligjit 115/2016.

Në përfundim të procedurës së votimit rezultoi se asnjë nga kandidatët për anëtar të Këshillit të Lartë Prokurorisë, nuk mori minimumin prej 4 votash të nevojshme për t’u konsideruar kandidat i miratuar nga nënkomisioni në përputhje me pikën 14 të nenit 35 të ligjit.

Në kushtet kur nga procedura e votimit nuk rezultoi asnjë kandidat me numrin e nevojshëm të votave sipas përcaktimeve të nenit 35, pika 14, të ligjit 115/2016, Kryetarja e nënkomisionit ftoi sekretariatit teknik të përgatisë procedurën e shortit për përzgjedhjen e kandidatëve fillimisht për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe më pas për Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Në përputhje me përcaktimet e Rregullores, shorti manual u zhvillua sipas kësaj procedure:

- emri i çdo kandidati nga lista përkatëse, i cili merr pjesë në short, i shënuar në shirita letre, u lexua me zë të lartë, iu tregua të pranishmëve dhe më pas u mbyll në gogla të njëjta nga ngjyra dhe forma e jashtme dhe hidhet në enën transparente;
- sekretaria teknike e nënkomisionit tërhoqi njërën nga goglat e hedhura në enën transparente, të cilën e hapi, e lexoi me zë të lartë, duke treguar emrin e kandidatit të përzgjedhur nga shorti.

Shorti u hodh sipas përcaktimeve të nenit 5, pika 8 të Rregullores së Nënkomisionit ku kandidati i përzgjedhur me votim plotëson vendin bosh që krijohet nga përfundimi i mandatit të anëtarit që është përzgjedhur i pari me short ose me votim në procesin e mëparshëm të përzgjedhjes së kandidatëve për Këshillin.

Në përfundim të procedurës së shortit për anëtarët nga radhët e avokatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor, rezultuan fitues kandidatët e mëposhtëm:

1. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor Fatmira Luli zëvendësohet nga Bledar Bajri;
2. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor Alban Toro zëvendësohet nga Albens Tabaku;

Më pas u vijua me procedurën e shortit për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për të cilën u zhvillua e njëjta procedurë e përshtuar më sipër. Në përfundim të procedurës së shortit rezultuan fitues kandidatët e mëposhtëm:

1. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nurihan Meta (Seiti) zëvendësohet nga Erind Mërkuri;
2. Anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë Tartar Bazaj zëvendësohet nga Erind Gërmenji;

Rezultatet e votimit dhe shortit gjenden bashkëlidhur, si pjesë e këtij raporti.

Pas përfundimit të procesit të votimit dhe të shortit, nënkomisioni miratoi listën përfundimtare me emrat e 2 kandidatëve nga radhët e avokatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe listën përfundimtare me emrat e 2 kandidatëve nga radhët e avokatëve për Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe vendosi përcjelljen e listave të raundit të tretë, Kryetarit të Kuvendit, në përputhje me parashikimet e pikës 15 të nenit 35 të ligjit 115/2016 dhe nenit 5 pika 8 të Rregullores së Nënkomisionit.

KLOTILDA BUSHKA

KRYETARE E NËNKOMISIONIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Nënkomisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe
Këshillit të Lartë të Prokurorisë*

REZULTATI I SHORTIT

Nr.	Kandidatët e përzgjedhur nga nënkomisioni për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve
1	Bledar Bajri
2	Albens Tabaku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut
Nënkomisioni për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe
Këshillit të Lartë të Prokurorisë*

REZULTATI I SHORTIT

Nr.	Kandidatët e përzgjedhur nga nënkomisioni për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve
1	Erind Mërkuri
2	Erind Gërmenji